

VENDIM
Nr. 484, datë 31.7.2018

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR TË ARSIMIT BAZË “BRITISH SCHOOL OF TIRANA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “*British School of Tirana*” shoqërisë “*British School of Tirana*” sh.p.k.

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “*British School of Tirana*” të ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: Rezidenca “Kodra e Diellit”, Rruga e Ullinjve, nr. 11, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “*British School of Tirana*”, mësimi të zhvillohet në gjuhën angleze. Në lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi shqipe”, “Histori e kombit shqiptar” dhe “Gjeografi e Shqipërisë” mësimi të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

4. Institucioni arsimor privat parauniversitar “*British School of Tirana*” të ofrojë arsimim parauniversitar në nivelin e arsimit bazë dhe forma e arsimimit të jetë arsimim me kohë të plotë.

5. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “*British School of Tirana*”, me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, për:

a) Numrin e nxënësve, që do të fillojnë dhe do të mbarojnë vitin shkollor, dhe listën e mësuesve, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) Planin mësimor dhe programet e lëndëve që do të zhvillojë institucioni;

c) Strukturën e vitit shkollor që do të ketë institucioni, e cila duhet të jetë e barasvlershme me atë të shkollave publike të të njëjtut nivel, së bashku me kalendarin e veprimtarive vjetore të institucionit;

ç) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

d) Lëndët mësimore të detyrueshme njëjloj me ato të shkollave publike;

dh) Lëndët mësimore të ndryshme nga ato të planeve mësimore të institucioneve ekuivalente publike;

e) Lëndët me zgjedhje dhe ato fakultative.

6. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “*British School of Tirana*” duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si edhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë, sipas rastit.

7. Ndryshimet që mund të pësojë institucioni arsimor privat parauniversitar i licencuar në vendndodhjen dhe në infrastrukturën e godinës shqyrtohen e miratohen në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas miratimit të njësisë arsimore vendore, 3 muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

8. Institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “*British School of Tirana*” duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) Regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar);

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

d) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

dh) Kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

9. Dokumentacioni i paraqitur në pikat 5, 6 e 8, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

10. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse e inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtij institucioni arsimor, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11. Në rast se institucioni arsimor privat nuk hapet gjatë dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjekti e humbet të drejtën e hapjes së institucionit.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësia arsimore vendore dhe institucioni arsimor privat parauniversitar “*British School of Tirana*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama